

Kush është përgjegjës i DAC-ve ?

Qyteti i Lozanës është përgjegjës për organizimin e detyrave të shoqëruara. Ai duhet të bëjë të mundur që fëmijët t'i bëjnë detyrat e shkollës në kushte të mira.

KUADRI LIGJOR

Ligji për arsimin e detyrueshëm (LEO) parashikon që :

- duke filluar nga 3P-ja, mësuesit-et tu japin fëmijëve detyra për t'i bërë jashtë kohës së mësimi të parashikuar në program në përputhje me direktivat e Departementit Mësuesit-et ua komunikojnë këto direktiva prindërve (neni 73) ;
- komunat organizojnë dhe financojnë survejimin e detyrave për fëmijët e regjistruar nga prindërit (neni 29).

Rregullorja e zbatimit të LEO-së thotë se institucionet kujdesen për harmonizimin e praktikave për sa u përket detyrave shkollore dhe për respektimin e kriterëve të mëposhtme (RLEO, neni 59) :

- ato bëhen në klasë ;
- ato nxënësit mund ti bëjnë edhe pa ndihmë ;
- ato nxisin mëvetësinë dhe përgjegjësimin ;
- ato konsolidojnë mësimet e mara në klasë ;
- ato verifikohen rregullisht prej mësuesve dhe mësueseve.

Fëmija juaj ka vështirësi në shkollë ? Ju mund të kontaktoni shkollën e fëmijës suaj ose Qendrën vaudeze të ndihmës për rininë (CVAJ - www.cvaj.ch)

www.lausanne.ch/dac

→ INFORMACIONET



Shërbimi i shkollave dhe ai jashtëshkollor
Drejtoria e fëmijërisë, rinisë dhe lagjeve
Place Chauderon 9 – 1003 Lausanne
021 315 64 11



Ville de Lausanne

Shërbimi i shkollave
dhe ai jashtëshkollor

**Detyrat e shoqëruara 3-6P
(DAC)**



Shkurt...

→ Detyrat e shoqëruara (DAC) përfaqësojnë një moment gjatë së cilit fëmijët bëjnë detyrat shkollore, në klasë, ose në APEMS të shoqëruar nga një i rritur.

...Për kë është?



Të gjithë nxënësit nga 3P-ja në 6P mund t'i bëjnë detyrat shkollore në DAC. Regjistrimi është i detyrueshëm.

...kur?



TË HËNËN, TË MARTËN dhe TË ENJTEN menjëherë pas shkollës.

...ku?



Në klasa, me grupe prej 10 fëmijësh.

PROGRAMI

15.40

Lojra dhe vakti i zemrës

16.15

Fillimi i detyrave të shoqëruara

FËMIJËT
NGA 3-4P

30 minuta
detyra të
shoqëruara

FUNDI NË
ORËN 16.45

FËMIJËT
NGA 5-6P

45 minuta
detyra të
shoqëruara

FUNDI NË
ORËN 17.00

Duke filluar nga 5P-ja, kur i mbaron detyrat, fëmija kthehet në shtëpi ose shkon në APEMS nëse është i regjistruar atje.

Çdo mungesë duhet t'i njoftohet bashkërenduesit-ses me telefon ose SMS.

Kush i inkuadron fëmijët?

Të rritur që nuk janë mësues-e dhe që bëjnë pjesë në skuadrën jashtëshkollore.

Ka 10 fëmijë në çdo grup.

Vlerat që drejtojnë skuadrat edukative:

- Kënaqësia për të qenë bashkë
- Besimi
- E drejta për të qenë i ndryshëm
- Pjesëmarrja e fëmijëve

Ç'bën skuadra?

Punonjësi i detyrave të shoqëruara **DUHET**:

- **TË BËJË KONTROLLIN E DETYRAVE** me fëmijën
- **TA INKURAJOJË** fëmijën për të bërë detyrat
- **T'I BËJË TË MUNDUR** fëmijës që ai të punojë në qetësi
- **TË NXISË** marrëdhënie plot respekt
- **TË KËRKOJË RESPEKTIMIN** e vendit dhe të materialit të vënë në dispozicion.

Punonjësi i detyrave të shoqëruara **MUND**:

- **TË SHPIJGOJË** kërkesën e një detyre nëse është e nevojshme
- **TË NXISË** punën në bashkëpunim
- **TI JAPË NJË DREJTIM** një fëmije që has një vështirësi në punë
- **T'IA PËRSËRISË** temën një fëmije që ia kërkon këtë.